

**“INTER DISTRIBUTION SERVICES” SH.P.K.**

**PASQYRAT FINANCIARE TË VITIT 2022**

**(Për periudhën 1 Janar -31 Dhjetor 2022)**

**( në LEKË )**



**PËRMBAJTJA**

**EMËRTIMI**

**FAQE**

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN NETO	6
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE	7-23



**Pasqyra e pozicionit financiar**


Aktive	Shenime	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
<b>Aktivët afatshkurtra</b>		<b>736,172,108</b>	<b>648,115,168</b>
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	4	151,923,424	39,712,311
Llogari të arketueshme tregtare	5	281,827,554	258,571,453
Inventar	6	264,529,997	309,859,993
Të arkëtueshme të tjera	7	33,609,123	39,971,411
Tatim fitimi i parapaguar	23.1	4,282,010	0
<b>Aktivët afatgjata</b>		<b>6,796,655</b>	<b>7,029,615</b>
Aktive afatgjata materiale	8	4,420,736	4,161,636
Aktive afatgjata jomateriale	9	2,375,919	2,867,979
<b>Totali I aktiveve</b>		<b>742,968,763</b>	<b>655,144,783</b>
<b>Detyrimet afatshkurte</b>		<b>422,783,918</b>	<b>363,171,601</b>
Llogari të pagueshme	10	3,840,990	7,027,822
Të pagueshme të tjera	11	34,942,930	34,559,609
Hua nga palet e lidhura	12.1	256,000,001	320,399,998
Tatim fitimi i parapaguar	23.1	0	1,184,172
<b>Detyrime afatgjata</b>		<b>127,999,997</b>	<b>0</b>
Hua nga palet e lidhuar	12.2	127,999,997	0
<b>Kapitali aksionar</b>		<b>291,973,182</b>	<b>291,973,182</b>
Kapitali aksionar	13	90,000,000	90,000,000
Fitim ose humbja	13	230,184,846	201,973,182
		<b>742,968,763</b>	<b>655,144,783</b>

Keto pasqyra financiare të lexohen së bashku me shenimet shpjeguese nr.1-27, të cilat janë pjesë integrale e tyre. Pasqyrat financiare janë nënshkruar në emër të shoqërisë nga:

**Ekonomist**




**Administrator**



**Pasqyra e performances**


	Shenime	Per vitin e mbyllur me 31.12.2022	Per vitin e mbyllur me 31.12.2021
Të ardhurat nga shitjet	14	17,558,257,743	14,635,460,554
Kosto e mallrave të shitur	15	(17,093,367,868)	(14,233,965,068)
<b>Fitimi bruto</b>		<b>464,889,875</b>	<b>401,495,486</b>
<i>Të ardhura të tjera</i>	22	<i>137,643,455</i>	<i>109,043,123</i>
Shpenzime te personelit	16	(184,923,604)	(139,585,958)
Shpenzime administrative	17	(106,562,899)	(93,450,241)
Shpenzime amortizimi	8, 9	(1,965,090)	(1,242,892)
(Shpenzime)/të ardhura operative të tjera neto	18	(9,978,526)	(11,406,822)
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>(303,430,119)</b>	<b>(245,685,913)</b>
<b>Fitimi nga aktiviteti operativ</b>		<b>299,103,211</b>	<b>264,852,696</b>
Shpenzime per zhvleresimin e aktiveve financiare afatshkurtra	19	-	-
Kosto financiare	20	(28,714,498)	(25,898,017)
Të ardhura/(humbje) neto nga kursi i këmbimit	21	(43,866)	(52,173)
Të ardhura të tjera	22		
<b>Fitimi para tatimit</b>	23	<b>270,344,847</b>	<b>238,902,506</b>
Shpenzime për tatim fitimin	23	(40,160,001)	(36,929,324)
Tatim fitimi i shtyre		-	-
<b>Fitimi neto</b>	23	<b>230,184,846</b>	<b>201,973,182</b>

Keto pasqyra financiare të lexohen së bashku me shenimet shpjeguese nr.1-27, te cilat janë pjesë integrale e tyre. Pasqyrat financiare janë nënshkruar në emër të shoqërisë nga:

**Ekonomist**  




**Administrator**



**Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare**

	<b>Per vitin e mbyllur me 31.12.2022</b>	<b>Per vitin e mbyllur me 31.12.2021</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		
Fitimi / (humbja) para tatimit	270,344,847	238,902,506
Rregullime për:		
Zhvlerësimin dhe amortizimin	(1,965,090)	(1,242,892)
Shpenzime interesi	25,275,472	23,637,175
Shpenzime jo monetare	4,325,877	411,656
<b>Fitimi në aktivitetin operativ para ndryshimit në kapitalin punues:</b>	<b>297,981,106</b>	<b>261,708,445</b>
Rritje në llogaritë e arkëtueshme	(23,256,101)	102,556,540
Rritje në llogaritë e arkëtueshme të tjera	2,080,278	(2,002,901)
Rritje/(rënie) në inventar	45,329,996	(16,702,325)
Rritje në llogaritë e pagueshme	(3,186,832)	(237,589,534)
Ritje në llogari të pagueshme të tjera	383,321	5,624,096
Interesi I paguar	(25,275,472)	(23,637,175)
Tatim fitimi i paguar	(41,344,173)	(32,907,957)
<b>Fluksi i mjeteve monetare neto e gjeneruar nga (përdorur në) veprimtaritë e shfrytëzimit</b>	<b>252,712,122</b>	<b>57,049,189</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga veprimtaritë e investimit</b>		
Blerje e aktiveve fikse materiale	(1,940,432)	(4,336,106)
Shitje e aktiveve fikse materiale	1,698	(292,334)
<b>Fluksi i mjeteve monetare neto e përdorur në veprimtaritë e investimit</b>	<b>(1,938,735)</b>	<b>(4,628,440)</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga veprimtaritë e financimit</b>		
Hua te mara nga Ortaket	398,500,000	743,300,000
Ripagim I huaveper Ortaket	(334,900,000)	(827,900,000)
Terheqje nga zvogelim kapitali	0	0
Kontribut ne kapital (ne para)	0	0
Dividendi i paguar	(201,973,182)	(173,844,712)
<b>Fluksi i mjeteve monetare neto e gjeneruar nga veprimtaritë e financimit</b>	<b>(138,373,182)</b>	<b>(258,444,712)</b>
<b>Rënie neto në mjeteve monetare dhe ekuivalentët e tyre</b>	<b>(112,400,206)</b>	<b>(206,023,963)</b>
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre në fillim të periudhës</b>	<b>39,712,311</b>	<b>245,847,523</b>
<b>Efekt i kursit te kembimit</b>	<b>(189,093)</b>	<b>(111,249)</b>
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre në fund të periudhës</b>	<b>151,923,424</b>	<b>39,712,311</b>

Ekonomist  
*[Signature]*



Administrator  
*[Signature]*

**Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto**

	Kapitali i paguar	Fitimi i pashërndarë	Totali
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>90,000,000</b>	<b>173,844,712</b>	<b>263,844,712</b>
Fitim i shpërndarë		-173,844,712	-173,844,712
Fitimi i vitit		201,973,182	201,973,182
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>90,000,000</b>	<b>201,973,182</b>	<b>291,973,182</b>
Fitim i shpërndarë		-201,973,182	-201,973,182
Fitimi i vitit		230,184,846	230,184,846
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2022</b>	<b>90,000,000</b>	<b>230,184,846</b>	<b>320,184,846</b>

Keto pasqyra financiare të lexohen së bashku me shenimet shpjeguese nr.1-27, te cilat janë pjesë integrale e tyre. Pasqyrat financiare janë nënshkruar në emër të shoqërisë nga:

**Ekonomist**

*Relal Jph*  
*RS*



**Administrator**

*Ervisë Robdulle*

**SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE**  
**për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022**

**1. Informacion i përgjithshëm**

Inter Distribution Services Sh.p.k. (referuar si “Shoqëria”) është Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar regjistruar më 05 Prill 2007, me numer identifikimi K71612801P dhe operon në përputhje me legjislacionin në fuqi nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, nga statuti dhe legjislacioni shqiptar në fuqi për tatimet dhe taksat si dhe ligjet e industrisë ku operon shoqëria.

Objekti i veprimtarisë: Gjatë vitit 2022 shoqëria ka kryer veprimtari në fushën e importit, eksportit dhe tregëtisë me shumicë dhe pakicë të cigareve të llojeve të ndryshme, të duhanit me ngohje e pajisjeve e aksesoreve përkatës. Të gjitha këto veprimtari janë brenda objektit të aktivitetit të shoqërisë dhe konform statutit e ligjeve në fuqi.

Kapitali i regjistruar: Vlera e kapitalit me 31 Dhjetor 2022 është 90,000,000 Lekë (31.12.2021: 90,000,000 LEKE) dhe përbëhet nga 3 kuota me vlerë nominale të njëjte të kontributit në para.

Kapitali i shoqërisë zotërohet nga ortakët:

1. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Investment Joti – Infosoft Group” sh.p.k., e cila zotëron një kuotë, që përfqëson 33.33% të kapitalit të Shoqërisë e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, Tiranë, më datë 25.02.2009, me NUIS K91425022E, me Administrator Z. Blerta Elezaj;
2. Z. Plarent Kristo, i cili zotëron një kuotë, që përfqëson 33.33% të kapitalit të Shoqërisë;
3. Z. Roland Joti, i cili zotëron një kuotë, që përfqëson 33.33% të kapitalit të Shoqërisë.

Shoqëria drejtohet nga administrator: Znj. Ervisa Rabdishta, me afat emërimi nga 01/01/2022 deri 31/12/2026, me të drejta, detyra, kufizim të kompetencave dhe afat emërimi, të përcaktuar në statutin e shoqërisë dhe të publikuar në regjistrin tregtar.

Adresa e selise : Kashar, Autostrada Tiranë - Durrës, KM.1, Pasuria Nr. 51/19, ZK. 2679, Tiranë, Shqipëri. Shoqëria kryen aktivitetin e saj në ambiente që janë nuk janë në pronësi të shoqërisë.

Me datë 31 Dhjetor 2022 shoqëria kishte 91 punonjës (me 31 Dhjetor 2021 ishte 82 punonjës).

**2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

**2.1. Bazat e përgatitjes**


Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (“SKK”). Shoqëria mban kontabilitetin dhe raporton pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (“SKK”), të shpallura me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr. 64 datë 22.07.2014 dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me efekt nga data 1 janar 2019.

**2.2. Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

**2.3. Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në Lek shqiptar (“LEKE”), e cila është monedha funksionale apo e mjedisit ekonomik kryesor, në të cilin vepron Shoqëria. Monedha e paraqitjes është Lek shqiptar (“LEKE”). Të gjitha vlerat janë rrumbullakosur në Lek, përveçse ku shprehet ndryshe.



## **2.4 Parimi i vijimësisë**

Drejtimi i Shoqërisë ka kryer një vlerësim të aftësisë për të vazhduar aktivitetin në vijimësi dhe vlerëson që Shoqëria ka burime të mjaftueshme dhe perspektivë për të vazhduar biznesin dhe aktivitetin në të ardhmen (12 muajt në vijim). Gjithashtu drejtimi nuk është në dijeni të ndonjë paisigurie materiale që mund të sjellë dyshime të konsiderueshme mbi mundësinë e shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten në bazë të parimit të vijimësisë.

## **2.5 Kompesimi (netimi)**

Aktivitet dhe detyrimet financiare janë të kompensuara me njëra tjetrën dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm në qoftë se ekziston një e drejte ligjore për të kompensuar shumën e njohur dhe Shoqëria ka një synim për t'i mbyllur ato mbi një bazë neto, ose të realizojë aktivitet dhe të shlyejë detyrimet njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet nuk janë kompensuar në pasqyrën e të ardhurave, përveç rasteve kur kërkohet ose lejohet nga ndonjë standard kontabiliteti apo interpretim kontabël.

## **2.6. Gjykime të rëndësishme kontabel, vlerësime dhe supozime**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë dhe në njohjen dhe matjen e shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Shembuj të zbatimit të vlerësimeve kontabël janë:

- (a) vlerësimi i zhvlerësimeve për kërkesat e arkëtueshme dhe inventarëve;
- (b) vlerësimi i jetës së dobishme të aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale, përcaktimi i normave përkatëse të amortizimit dhe i zhvlerësimeve të aktiveve;
- (c) krijimi i provizioneve për shitjet me garanci ose për mbulimin e kostove që lidhen me procedurat gjyqësore në proces. Në veçanti, informacioni mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishëm në shumën e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet shpjeguese përkatëse të këtyre pasqyrave financiare.
- (d) Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Është i nevojshëm gjykimi për përcaktimin e shumës së tatimit mbi fitimin aktual dhe atyre të shtyra. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar tatimor është i pasigurt. Shoqëria njih detyrimin në rast të auditimit të pritur tatimor bazuar në vlerësimet se taksa shtesë do mund të lindin si detyrim. Nëse tatimi përfundimtar do jete i ndryshëm nga shumën që ishin regjistruar fillimisht, diferencat do të ndikojnë në vlerën aktuale të aktiveve tatimore të shtyra dhe pasiveve në periudhën në të cilën një përcaktim i tillë është bërë.

## **3. Përmbledhje e politikave kontabël**

Politikat kontabël të përshkruara më poshtë janë zbatuar janë zbatuar në mënyrë konsistente nga shoqëria.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare janë zbatuar parimet kontabël që njihen si më të përshtatshme për të matur dhe paraqitur gjendjen financiare, rezultatit financiar dhe flukset e parasë mbi gjendjen e kontabilitetit rrjedhës (të drejtat dhe detyrimet e konstatuara).

Matja fillestare e aktiveve dhe detyrimeve që plotësojnë kriterin e njohjes, bëhet me kosto historike, përveç rasteve kur SKK 1, kërkon matje fillestare mbi një bazë tjetër të tillë si vlera e drejtë. Vlerësimi i mëpasshëm i aktiveve dhe detyrimeve financiare bëhet me kosto të amortizuara minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm, sikurse përcaktohet në SKK 3, ndërsa të aktivitet dhe pasivitet të tjera duhet të referohemi rast pas rasti SKK-ve përkatëse.





### **3.1 Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat përfaqësojnë flukse hyrëse (rritjen e përfitimeve ekonomike) gjatë periudhës raportuese, që çojnë në rritjen e aktiveve ose pakësimin e pasiveve, si dhe që rrisin kapitalin e njësisë ekonomike raportuese, duke përjashtuar këtu ato flukse që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital.

Të ardhurat përfshijnë vetëm hyrjet bruto të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga njësia ekonomike për llogari të vet. Shumat e mbledhura për llogari të palëve të treta si taksat e shitjes, taksat e mallrave, produkteve dhe shërbimeve, si dhe tatimi i vlerës së shtuar nuk janë përfitime ekonomike që hyjnë në njësinë ekonomike dhe nuk sjellin rritje të kapitalit neto. Për këtë arsye ato nuk përfshihen në të ardhura.

Të ardhurat përfshijnë vetëm vlerën e drejte të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga shitja e mallrave dhe shërbimeve gjatë aktivitetit të zakonshëm të kompanisë.

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri

Një njësi ekonomike duhet të masë të ardhurat me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme. Vlera e drejtë e shumës së arkëtuar apo për t'u arkëtuar merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

### **3.2 Shitja e mallrave**

Të ardhurat nga shitja e mallrave të tipit cigare, duhan me ngrohje dhe aksesore, do të njihen kur janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme:

(a) njësia ekonomike ia ka kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, që lidhen me pronësinë e mallrave dhe produkteve;

(b) njësia ekonomike nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në menaxhimin e mallrave dhe të produkteve në atë masë që tregon se ende zotëron titullin e pronësisë dhe/ose ka kontroll efektiv mbi mallrat/produktet e shitura;

(c) shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri;

(d) është e mundur që përfitimet ekonomike, që lidhen me transaksionin, do të merren nga njësia ekonomike;

(e) kostot që kanë ndodhur, ose që do të ndodhin në lidhje me transaksionin, mund të maten me besueshmëri.

### **3.3 Kontratat e shërbimit**

Kur rezultati i një transaksioni që përfshin ofrimin e një shërbimi mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, një njësi ekonomike do të njohë të ardhurat e lidhura me transaksionin duke iu referuar fazës së përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese (nganjëherë referuar si metoda e përqindjes së përfundimit).

### **3.4 Njohja e shpenzimeve**

Shpenzimet që lidhen me të ardhurat e fituara gjatë periudhës raportuese njihen në të njëjtën periudhë kontabel si dhe të ardhurat perkatese. Shpenzimet e kryera gjatë një periudhë raportuese, që ndryshon nga periudha kur ato i sjellin përfitime njesise ekonomike raportuese, regjistrohen si shpenzime pikerisht në periudhën kur merren përfitimet. Shpenzimet e ndodhura, për të cilat njësia ekonomike nuk prët përfitime të ardhshme, njihen menjëherë në rezultatin financiar.

### **3.5 Transaksionet e qirase**

Shoqëria ka njohur qirate si qira të zakonshme bazuar në afatin e qirase, vlerën dhe kushtet e kontratës. Qiraja është një marrëveshje ku qiradhënësi i kalon qiramarrësit të drejtën e përdorimit të një aktivi për një periudhë të caktuar kohe, kundrejt një ose disa pagesave. Marrëveshjet e qirasë do të klasifikohen ose si qira financiare ose si qira e zakonshme. Faktori përcaktues për klasifikimin e qirave është niveli deri ku rreziqet dhe përfitimet, që lidhen me pronësinë e një aktivi të dhënë me qira i takojnë qiramarrësit apo qiradhënësit.

Meqenëse transaksioni mes qiradhënësit dhe qiramarrësit bazohet në një marrëveshje qiraje të përbashkët, që është e detyrueshme për të dyja palët, të dyja palët duhet të përdorin të njëjtat përkufizime kur bëjnë



klasifikimin e marrëveshjeve të qirasë. Nga ana tjetër, meqenëse të dyja palët përdorin supozime të ndryshme për klasifikimin e marrëveshjeve të qirasë, në rrethana të caktuara, qiradhënësi dhe qiramarrësi mund të klasifikojnë të njëjtën marrëveshje qiraje në mënyra të ndryshme.

Qiraja financiare është qiraja, nëpërmjet së cilës qiramarrësit i kalohen nga qiradhënësi të gjitha rreziqet dhe përfitimet e rastësishme të pronësisë së aktivitetit. Titulli mund t'i kalojë ose jo qiramarrësit.

Qiraja e zakonshme është çdo lloj qiraje tjetër, përveç asaj financiare, d.m.th. është qiraja, nëpërmjet së cilës qiramarrësit nuk i kalohen nga qiradhënësi të gjitha rreziqet dhe përfitimet e rastësishme të pronësisë së aktivitetit.

### **3.6 Instrumentat financiare**

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar të një njësie ekonomike dhe një pasiv financiar ose instrument kapitali neto të një njësie ekonomike tjetër. Instrumentet financiare jo-derivative të Shoqërisë përbëhen nga paratë dhe ekuivalentët e tyre, të arkëtueshmet tregtare dhe të arkëtueshme të tjera, llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera, të arkëtueshme dhe të pagueshme nga njesite ekonomike pjesë e grupit, huamarrjet dhe huadheniet.

### **3.7 Aktivët financiare**

Një njësi duhet të njohë një aktiv financiar ose një detyrim financiar vetëm kur njësia bëhet pjesë e kushteve kontraktuale të instrumentit. Kur një aktiv financiar ose një detyrim financiar njihet fillimisht, një njësi duhet ta masë atë me kostot e transaksionit (duke përfshirë edhe çmimin e transaksionit) përveç rasteve kur marrëveshja përbën në thelb, një transaksion financiar. Nëse marrëveshja përbën një transaksion financiar, njësia duhet të masë aktivin financiar ose detyrimin financiar me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me normën e interesit të tregut për një instrument të ngjashëm borxhi.

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi. Në këtë rast janë përfshirë kërkesa të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit, hua si dhe kërkesa të tjera debitoare afatshkurtra, të cilat në njohjen fillestare janë vlerësuar me vlerën e paskontuar apo me koston e transaksionit. Pas njohjes fillestare, aktivët financiare me kosto të amortizuar maten duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe janë subjekt i rënies në vlerë (zhvlerësimi). Fitimet dhe humbjet njihen në fitim ose humbje kur aktiviteti çregjistrohet, modifikohet ose zhvlerësohet. Aktivët financiare të Shoqërisë që maten me koston e amortizuar përbëhen kryesisht nga të drejta të arkëtueshme.

Në fund të çdo periudhe raportimi, një njësi duhet të vlerësojë nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit të ndonjë aktiviteti financiar që matet me kosto ose me kosto të amortizuar. Nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit, njësia duhet të njohë menjëherë një humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje.

### **3.8 Detyrimet financiare**

Në këtë grup janë përfshirë detyrimet e pagueshme ndaj furnitoreve, ortakëve për dividendë, hua dhe interesa, punonjesve, administratës tatimore, kreditorëve të tjerë, etj. Në njohjen fillestare zerat e këtij grupi janë vlerësuar me kosto. Në fund të vitit detyrimet vlerësohen sipas rastit me kosto apo me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Metoda e interesit efektiv është një metodë e llogaritjes së koston të amortizuar të një aktiviteti financiar ose një detyrimi financiar (ose një grup aktivitetesh ose detyrimesh financiare) dhe e shpërndarjes së të ardhurave të interesit ose shpenzimeve të interesit përgjatë periudhës përkatëse.

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale paguhen, anulohen ose skadojnë.

Shoqëria gjithashtu çregjistron një detyrim financiar kur kushtet e tij kontraktuale ndryshojnë dhe rrjedhimisht flukset monetare të detyrimit të modifikuar ndryshojnë thelbësisht. Në këtë rast njihet një detyrim financiar i ri, me vlerën e drejtë, i bazuar në kushtet e modifikuara. Në çregjistrimin e një detyrimi financiar, diferenca mes vlerës kontabël neto dhe shumës së paguar (duke përfshirë çdo aktiv jomonetar të transferuar apo detyrime të supozuara) njihet si fitim ose humbje.



### 3.9 Inventarët

Inventarët janë aktivet e mbajtura nga shoqëria për shitje në rrjedhën normale të aktivitetit të saj. Ajo njeh inventarin atëherë kur e ka nën kontroll, pret përfitime ekonomike prej tij dhe kostoja e tij mund të vlerësohet me besueshmëri. Inventarët maten fillimisht me kosto. Kostoja e inventarit përfshin përveç çmimit të blerjes, zbritjet tregtare dhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese. Pas njohjes fillestare njësisia ekonomike e mat inventarin me vlerën më të ulët midis koston dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për t'u përfunduar dhe shitur. Për të përcaktuar koston e inventarit shoqëria përdor metoden koston mesatare të ponderuar.

### 3.10 Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, si pjesë e aktiveve financiare, përfshijnë gjëndjet e arkës, llogaritë rrjedhëse bankare dhe depozitat afatshkurtra bankare. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfaqësojnë para dhe depozita të pakufizuara ose me maturitet tre muaj ose më pak, të përcaktuara si më sipër.

### 3.11 Detyrime/të drejta tatimore

Si pjesë e një aktivi apo detyrimi financiar, të drejtat dhe detyrimet tatimore përfshijnë të gjitha llojet e tatimeve e taksave, të paguara dhe për tu paguar ndaj administratës tatimore, të cilat vlerësohen me kosto (me vlere të paskontuar). Detyrimet tatimore afatshkurtra dhe afatgjata nuk skontojnë dhe nuk zhvlerësohen.

### 3.12 Aktive afatgjata materiale dhe jo materiale (AAM dhe AAJM)

Aktivitet afatgjata materiale (AAM) janë aktive materiale që përdoren nga njësisia ekonomike për kryerjen e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve apo përdoren për qëllime administrative, për më shumë se një periudhë kontabël. Aktivitet afatgjata materiale maten me kosto dhe paraqiten në pasqyrat financiare me vlere neto, duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Shoqëria ka klasifikuar si aktive afatgjata materiale inventarët që përdoren për qëllime administrative dhe perbehen pajisje informatike, programe informatike, mobilje e pajisje zyre, etj. Aktivitet Afatgjata Materiale janë vlerësuar me koston e blerjes dhe kosto të tjera të drejtperdrejta që lidhen me sjelljen e aktivitetit në kushtet normale për funksionimin e tij.

Metoda për llogaritjen e amortizimit për të gjitha AAM e shoqërisë, është metoda e vlerësimit mbetur, e përcaktuar në Ligjin nr. 8438 datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat" të ndryshuar.

Normat vjetore të amortizimit të vitit 2022 por të aplikuar edhe me pare janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Pershkrimi	Norma vjetore	Metoda e amortizimit
Pajisje informatike	25%	Me vlere e mbetur
Programe informatike	25%	Me vlere e mbetur
Pajisje pune e orendi	20%	Me vlere e mbetur

Kjo mënyrë pasqyron më përafërsisht trendin e konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike të përfshira në këto aktive. Aktivitet në proces nuk amortizohen.

Në çdo datë raportimi Shoqëria rishikon vlerën kontabël të aktiveve jo-financiare, përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra, për të përcaktuar nëse ka tregues për zhvlerësim. Nëse ka tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit në mënyrë që të përcaktohet zhvlerësimi. Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose njësisë gjeneruese të parasë është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus koston e shitjes.

Për përcaktimin e vlerës në përdorim, skontojnë flukset e ardhshme të parasë duke përdorur normën e skontimit para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqeve specifike të aktivitetit, për të cilat nuk janë bërë rregullime në vlerësimet e bëra për fluksin e mjeteve monetare.



Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi apo e njësisë së tij gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

### **3.13 Provizionet**

Provizioni njihet nëse si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose kontraktual dhe nëse ekziston mundësia që të kërkohet një dalje burimesh ( përfitimet ekonomike) për të shlyer detyrimin, e cila mund vlerësohet në mënyrë të besueshme. Provizionet përcaktohen duke skontuar rrjedhat e ardhshme të parasë me një normë para tatimit, e cila paraqet vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike që lidhen me atë detyrim

### **3.14 Përfitimet e punonjësve**

Kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore dhe pensionet

Gjatë ecuresë normale të biznesit, shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet shoqërore, të cilat janë të detyrueshme bazuar në legjislacionin vendas. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin e ndodhjes.

Leje vjetore e paguar

Të gjithë punonjësit kanë të drejtën e lejes vjetore të paguar bazuar në legjislacionin aktual vendas.

### **3.15 Kapitali**

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kuota e kapitalit, e cila përfaqëson kontributin e ortakëve në kapitalin e regjistruar të shoqërisë. Kapitali njihet me kosto, sikurse përcaktohet në statutin e shoqërisë.

### **3.16 Shpërndarjet e fitimit**

Shoqëria i njej shpërndarjet e fitimit si detyrim, në kohën e deklarimit të tyre.

### **3.17 Të ardhura të tjera dhe shpenzime financiare**

Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e metodës lineare ose të metodës së bazuar në normën e interesit efektiv (kontabilizimi, në bazë të normës së brendshme të interesit efektiv, përshkruhet gjithashtu në SKK 3, Instrumentet Financiare); Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi nga fondet e investuara në depozita bankare afatshkurtra si dhe fitimet nga kursi i këmbimit.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë, humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare nëpërmjet fitimit dhe humbjes dhe humbje nga rënia në vlerë e aktiveve financiare (nëse ka). Të ardhurat nga kursi i këmbimit raportohen në bazë neto.

### **3.18 Tatimi mbi të ardhurat**

Tatim fitimi përbëhet nga tatimi aktual dhe i shtyrë. Shpenzimi tatim fitimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, përveçse në rastet kur lidhet me elementë që njihen direkte në kapital, në të cilat njihet direkt në kapital. Tatimi aktual është shuma e pritur e tatimit të pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

